

Deklaratë e Unionit të Gazetarëve Shqiptarë

Gjendja sociale dhe financiare e gazetarëve në Shqipëri është kritike. Unioni i Gazetarëve refuzon të propozojë anëtarë për Bordin e Monitorimit të Mediave në KQZ

Unioni i Gazetarëve Shqiptarë sot në 3 maj, Ditën Botërore të lirisë së Shtypit proteston dhe denoncon gjendjen e patolerueshme dhe të përkeqësuar të situatës sociale e financiare të qindra gazetarëve të vendit. Janë më tepër se kurrë tronditëse të dhënat që publikon sot organizata jonë për situatën në mediat shqiptare.

Në 23 gazetatat e përditshme socio-politike të vendit vetëm në 4 prej tyre respektohen dhënia e pagave korrekte në kohë dhe ato janë Panorama, Gazeta Shqiptare, Shqiptarja.com, Shqip. Në 19 gazetatat e tjera vonesat janë të përhershme dhe gjithashtu edhe ikjet e gazetarëve nga puna pa përfituar shpërblimet e punës së kryer.

Në 72 televizionet e vendit, të listuar sipas Autoritetit të Medias Audiovizive, vetëm në 10 prej tyre nuk ka vonesa të pagave dhe detyrimeve financiare ndaj punonjësve, të cilat janë RTVSH, Top Channel, Neës 24, A1 Report, Klan, dhe disa televizione lokale. Ndërsa në 62 prej tyre, vonesat vijnë nga një gjer në pesë e gjashtë muaj, përfshirë në këtë gjendje edhe televizione kombëtare. Në 71 radiot, 63 prej tyre janë në riciklim vonesash të pagave në mënyrën më arbitrare të cilat nisin nga një muaj e shkojnë deri në pesë muaj.

Të njëjtën gjendje po ndjek edhe media më e re, ajo on line. Nga 250 webe dhe gazeta online të celura përgjatë periudhës 2014 e gjer më sot, në të cilat na rezulton të jenë punësuar mbi 320 gazetarë, vetëm në 50 prej tyre ka një sistem modest pagesash, ndërsa në 200 prej tyre ka një realitet informal të tmerrshëm.

Nisur nga kjo tablo dhe gjendja në përkeqësim që kemi para, ne sot në Ditën Botërore të lirisë së Shtypit kërkojmë:

Se nisur nga vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara , i kujtojmë parlamentit dhe Qeverisë së vendit detyrën e pakryer dhe detyrimin kushtetues që kanë në drejtim të lirisë dhe respektimit të saj.

Aktualisht asnjë prej mediave të vendit nuk respekton nënshkrimin dhe implementimin e asnjë kontrate kolektive për gazetarët. Kjo situatë është jashtë kontrollit dhe auditimit ligjor nga institucionet e linjës.

Ne kërkojmë sot publikisht një seancë dëgjimore në Komisionin Parlamentar të Medias, madje duke ftuar edhe përfaqësuesit e shoqatës së pronarëve të mediave, për ta nxjerrë gjendjen nga ky standart dhe për t'i dhënë më shumë dinjitet medias dhe sidomos gazetarëve shqiptarë.

Unioni i Gazetareve Shqiptare